



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.112**

**24 gusht**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

|                                          |                                                                                                                                                                                                                                                               | Faqe |
|------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i KM<br>nr.504, datë 8.8.2007     | Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të çmimit të barnave..                                                                                                                                                                                             | 3209 |
| Vendim i KM<br>nr.507, datë 8.8.2007     | Për miratimin e kontratës, me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, blloku detar Joni-5, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Medoil, plc .....                                    | 3210 |
| Vendim i KM<br>nr.508, datë 8.8.2007     | Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.632, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, femra" .....                                                                                      | 3211 |
| Vendim i KM<br>nr.509, datë 8.8.2007     | Për miratimin e marrëveshjeve hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet Ballsh-Hekal, Gorisht-Kocul, Cakran-Mollaj dhe në vendburimin e Delvinës, ndërmjet Albpetrol sh.a.-së dhe STREAM OIL&GAS Limited...                  | 3211 |
| Vendim i KM<br>nr.512, datë 8.8.2007     | Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për realizimin, me shoqërinë "Microsoft", të projektit të partneritetit strategjik, në fushën e teknologjisë së informacionit... | 3212 |
| Udhëzim i METE<br>nr.562, datë 15.8.2007 | Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.162, datë 7.3.2007 "Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore" .....                                                                       | 3212 |
| Udhëzim i MF<br>nr.18, datë 21.8.2007    | Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.448, datë 13.7.2007 "Për rritjen e pensioneve" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.501, datë 16.8.2007 "Për disa ndryshime në vendimin                                                        |      |

nr.448, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për rritjen e  
pensioneve” .....

3215

Njoftim i MD  
nr.5063, datë 24.8.2007

Për vende vakante për noter në Bashkinë, Tiranë ..... 3216

**VENDIM**  
**Nr.504, datë 8.8.2007**

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ÇMIMIT TË BARNAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 50 e 51 të ligjit nr.9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e komisionit të çmimit të barnave, si njësi e përhershme, pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Komisioni të kryesohet nga drejtori i Drejtorisë Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe të ketë në përbërje:

- një përfaqësues të Drejtorisë Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë anëtar;
- dy përfaqësues nga Ministria e Financave anëtarë;
- një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës anëtar;
- dy përfaqësues nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor anëtarë.

Sekretar i komisionit është një punonjës i Drejtorisë Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë.

Titullarët e institucioneve, të përmendura në këtë pikë, caktojnë në detyrën e anëtarit të komisionit të çmimit të barnave punonjës, që kanë lidhje me funksionin dhe detyrat e këtij komisioni.

3. Komisioni i çmimit të barnave miraton çdo vit kalendarik çmimet maksimale CIF, për barnat e importit dhe çmimet e fabrikimit, për barnat e prodhuara në vend.

4. Fabrikuesit, brenda datës 31 tetor të çdo viti, deklarojnë me shkresë, në zarf të mbyllur pranë Drejtorisë Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë, drejtpërdrejt apo nëpërmjet zyrës së përfaqësimit të tyre në vendin tonë, çmimet CIF (në euro ose dollarë), për barnat e importit apo çmimet e fabrikimit (në lekë), për barnat e prodhuara në vend.

Drejtorja Farmaceutike njofton, zyrtarisht, fabrikuesin për dorëzimin e informacionit mbi çmimet, që duhen deklaruar, jo më vonë se dy muaj para mirimit të afatit të përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike.

5. Komisioni i çmimit të barnave, me njoftim të kryetarit, mblidhet një herë në vit, për të shqyrtuar informacionin e paraqitur nga sekretari në përputhje me pikat 3 e 4 të këtij vendimi dhe e miraton atë brenda datës 5 nëntor të çdo viti. Drejtorja Farmaceutike, e cila harton listën përfundimtare të çmimit të barnave, njofton zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe institucionet e tjera, të interesuara, si dhe shpall në “Buletinin e Njoftimeve Publike”, brenda datës 5 dhjetor të çdo viti, listën e barnave, me çmimet e miratuara, mbi të cilat do të zbatohen marzhet e tregtimit për vitin pasardhës.

6. Mbledhja e komisionit është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Miratimi i listës së çmimit të barnave bëhet me votim të hapur dhe vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazie votash, vota e kryetarit është vendimtare.

Sekretari i komisionit përgatit dokumentacionin e mbledhjes, të cilin, pas miratimit nga kryetari, ia dërgon çdo anëtar, 7 ditë para mbledhjes.

Gjithashtu, ai mban procesverbalin e mbledhjes, të cilin ua paraqet për miratim të gjithë anëtarëve të pranishëm, në fund të mbledhjes apo në fillim të mbledhjes pasardhëse. Procesverbali i miratuar nga anëtarët nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari i komisionit.

7. Komisioni i çmimit të barnave, kur është e nevojshme, mund të mblidhet me kërkesë të kryetarit ose të paktën të dy anëtarëve, për të shqyrtuar dhe miratuar çmimet e deklaruara për barnat që regjistrohen gjatë vitit kalendarik. Në këto raste, miratimi i çmimit të barnave bëhet brenda 30 ditëve pas depozitimit të deklarimit të tyre, pranë Drejtorisë Farmaceutike.

Çmimet e miratuara nga komisioni i çmimit të barnave, sipas kësaj pike, i bashkëlidhen listës përfundimtare të barnave me çmimet maksimale CIF, të miratuara në pikën 5 të këtij vendimi.

Edhe në këtë rast, për miratimin e çmimit të barnave zbatohen procedurat e përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Barnat që nuk përfshihen në listën e përmendur në pikën 5 të këtij vendimi, për shkak të mosdeklarimit brenda datës 31 tetor të vitit aktual apo që regjistrohen pas kësaj date dhe që nuk janë alternativë të vetme në treg, humbasin të drejtën për t'u futur në listën e barnave të rimbursuara për vitin pasardhës.

9. Kur Komisioni i çmimit të barnave shkel afatet e përcaktuara për miratimin e listës me çmimet e deklaruara të barnave, fabrikuesit i lind e drejta e tregtimit të tyre me çmimet e vetëdeklaruara.

Për çdo vendim për mosmiratimin e çmimit të barnave, sipas deklarimit të fabrikuesit, komisioni argumenton, në mënyrë objektive dhe të mbështetur mbi kritere të verifikueshme, arsyet e këtij vendimi.

10. Kundër vendimit të komisionit të çmimit të barnave, fabrikuesi mund të bëjë ankim në gjykatë, brenda 30 ditëve nga shpallja e tij.

11. Anëtarët e komisionit, për çdo mbledhje shpërblehen me 5000 (pesë mijë) lekë, nga fondet buxhetore, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

12. Vendimi nr.152, datë 7.3.2007 i Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të çmimit të barnave", shfuqizohet.

13. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**

#### **VENDIM**

**Nr.507, datë 8.8.2007**

#### **PËR MIRATIMIN E KONTRATËS, ME NDARJE PRODHIMI, PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË SHQIPËRI, BLOKU DETAR JONI-5, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE MEDOIL, PLC**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Miratimin e kontratës, me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, blloku detar Joni-5, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe MEDOIL, plc, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**

#### **VENDIM**

**Nr.508, datë 8.8.2007**

#### **PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.632, DATË 18.9.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE" PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË, FEMRA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, pika 5 e 8, pika 3, të ligjit nr.7995,

datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.632, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ky ndryshim e kjo shtesë:

1. Në shkronjën "c", pika 4, shprehja "tetë pagave" zëvendësohet me "katër pagave".

2. Në pikën 6 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Nëse punëdhënësi bën zgjidhje, të menjëhershme e të pajustificuar, të kontratës së punës për punëmarrësin, e vërtetuar kjo me vendim gjykatë, të formës së prerë, është i detyruar të kthejë të gjithë financimin e marrë, nga datat e dhënies së tij, së bashku me interesat, sipas normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.509, datë 8.8.2007**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJEVE HIDROKARBURE, PËR ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË VENDBURIMET BALLSH-HEKAL, GORISHT-KOCUL, CAKRAN-MOLLAJ DHE NË VENDBURIMIN E DELVINËS, NDËRMJET ALBPETROL, SHA-SË DHE STREAM OIL&GAS LIMITED**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e marrëveshjeve hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Ballsh-Hekal, ndërmjet Albpetrol sh.a.-së dhe STREAM OIL&GAS Limited, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e marrëveshjes hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Gorisht-Kocul, ndërmjet Albpetrol sh.a.-së dhe STREAM OIL&GAS Limited, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Miratimin e marrëveshjes hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Cakran-Mollaj, ndërmjet Albpetrol sh.a.-së dhe STREAM OIL&GAS Limited, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Miratimin e marrëveshjes hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Delvinës, ndërmjet Albpetrol sh.a.-së dhe STREAM OIL&GAS Limited, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.512, datë 8.8.2007**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR REALIZIMIN, ME SHOQËRINË "MICROSOFT", TË PROJEKTIT TË PARTNERITETIT STRATEGJIK, NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t'i shtohet fondi prej 142 000 000 (njëqind e dyzet e dy milionë) lekësh, si pjesë e fondit të përgjithshëm 426 000 000 (katërqind e njëzet e gjashtë) milionë lekë, për realizimin, me shoqërinë "Microsoft", të projektit të partneritetit strategjik, në fushën e teknologjisë së informacionit.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**UDHËZIM**  
**Nr.562, datë 15.8.2007**

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.162, DATË 7.3.2007**  
**“PËR DHËNIEN ME QIRA OSE ENFITEOZË TË PASURIVE TË NDËRMARRJEVE,**  
**SHOQËRIVE DHE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të kapitullit IX të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.162, datë 7.3.2007 “Për dhënie me qira ose enfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,

**UDHËZON:**

1. Procedurat e konkurrimit, për dhënie me qira ose enfiteozë të pronës shtetërore, kryhen prej organit që ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë ose enfiteozës.

2. Institucioni që pajis subjekte private me leje shfrytëzimi të pasurive minerare, peshkimit, ujërave etj., plotëson dokumentacionin për dhënie me qira të aseteve, sipas përcaktimit në kapitullin e II-të pika 1 të vendimit të cituar dhe e përcjell në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shqyrton dokumentacionin dhe autorizon në emër dhe për llogari të saj, institucionin që ka lëshuar lejen e shfrytëzimit për të lidhur dhe monitoruar kontratën e qirasë. Kontrata e qirasë lidhet për periudhë jo më të gjatë se afati i lejes së dhënë.

3. Te kapitulli i II-të në pikën 1-c, me shprehjen konfirmim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të kuptohet vërtetim nga kjo zyrë se objekti është i regjistruar si pronë shtetërore, ndërsa në pikën 1-ç me shprehjen konfirmim nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të pronave do të kuptohet që kjo Agjenci të shprehet nëse, për objektin e propozuar për të dhënë me qira, ka dalë ose jo një vendim për njohje ose kthim për pasurinë ish-pronarëve.

Në rastet kur objekti që jepet me qira është në administrim të shoqërive, ku zotërues i 100 për

qind të aksioneve është shteti, nuk është e nevojshme marrja e konfirmimit nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Në zbatim të pikës 6-c të kapitullit të I-rë, subjektet qiramarrëse kërkesën për ripërsëritje të kontratës së qirasë duhet ta shoqërojnë me dokumentet sipas pikës 5-b dhe 5-d të kapitullit të II-të të vendimit, si dhe me vërtetimin ose aktrakordin me subjektin qiradhënës për respektim të kushteve të kontratës. Tarifat që do të zbatohen në ripërsëritjen e kontratës do të jenë ato që janë në fuqi në momentin e ripërsëritjes, ndërsa afati i ripërsëritjes do të bëhet vetëm një herë dhe nuk do të jetë më i madh se afati i kontratës bazë.

5. Në zbatim të pikës 6-ç të kapitullit të I-rë, në kontratat e qirasë ose enfiteozës të lidhura me sipërfaqe mbi 500 m<sup>2</sup> mund të bëhet pa konkurrim shtesë në sipërfaqen e marrë në përdorim deri në 500 m<sup>2</sup>, pasi subjekti qiramarrës ose enfiteozëmarrësi do të paraqesë kërkesën për shtesë, si dhe planbiznesin shtesë, ndërsa institucioni që ka në administrim objektin do të paraqesë miratimin e organit drejtues dhe genplanin e sipërfaqes shtesë të përgatitur sipas pikës 1-b të kapitullit të II-të, të vendimit të cituar. Llogaritja e detyrimit të qirasë për sipërfaqen shtesë bëhet sipas tarifave të zbatuara në kontratën bazë.

6. Në kontratat e qirasë të lidhura për objekte me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup> deri në 500 m<sup>2</sup>, para daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave nr.162, datë 7.3.2007, nuk do të aplikohet ripërsëritje e afatit dhe shtesa mbi sipërfaqen e marrë me qira.

7. Në zbatim të pikave 1 dhe 2 të kapitullit IV-të të vendimit, procedurat për përfitimin e zbritjes kryhen nga qiradhënësi, me kërkesë të qiramarrësit. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin:

a) Vërtetim të lëshuar nga organet kompetente për punësimin mesatar mujor të realizuar nga qiramarrësi në vitin përkatës;

b) Raport i ekspertit kontabël për investimet e realizuara nga qiramarrësi në objektin e marrë me qira dhe të paraqitura në bilanci financiar të shoqërisë qiramarrëse;

c) Bilancin financiar të shoqërisë qiramarrëse për vitin përkatës, të dorëzuar në degën e tatimeve.

Zbritja e detyrimit mujor për nivelin e punësimit të realizuar mbrohet çdo vit nga qiramarrësi me dokumentacion përkatës, ndërsa zbritja e detyrimit mujor për nivelin e investimit të realizuar vlen deri në përfundim të kontratës.

Zbritja e detyrimit mujor, e llogaritur si më lart fillon për vitin pasardhës të raportuar.

8. Në zbatim të pikës 7 të kapitullit I-rë të vendimit, afati i lidhjes së kontratave të qirasë për objekte me sipërfaqe deri në 500 m<sup>2</sup> do të jetë deri në 5 vjet, ndërsa për objektet me sipërfaqe mbi 500 m<sup>2</sup> deri në 20 vjet.

9. Në zbatim të pikës 3 të kapitullit IV-të të vendimit, procedohet si vijon:

Organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit, pasi shqyrton propozimet e përgatitura sipas pikës 1 në kapitullin e II-të të këtij vendimi, i propozon Këshillit të Ministrave për rastet kur është në interes të aplikohet kontrata me tarifë 1 euro, për ushtrim të aktivitetit prodhues. Me daljen e vendimit të Këshillit të Ministrave për kontratë me tarifën 1 euro, organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit fillon procedurat sipas pikave të tjera në kapitullin e II-të të vendimit të cituar dhe kriterëve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave të mësipërm.

Subjekti që fiton të drejtën e lidhjes së kontratës me tarifën 1 euro, para firmosjes së saj depoziton një vlerë garancie kontrate në masën 10% të vlerës së investimit të marrë përsipër në konkurrim.

10. Në zbatim të pikës 2 të kapitullit të VIII-të, për rastet kur pasuria e ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore e dhënë me kontratë qiraje ose enfiteozë, i është kthyer ose njohur me të drejtë parablerjeje pronarit, në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, ky i fundit i paraqet qiradhënësit kërkesën për përfitim të vlerës së detyrimit të paguar nga përdoruesi. Kërkesa shoqërohet me vendimin përkatës të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo çdo dokumenti tjetër ligjor të regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ku përcaktohet se ai është pronar i tokës. Organi shtetëror që ka lidhur kontratën kur e sheh të nevojshme, kërkon konfirmimin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Pasi shqyrtohet dokumentacioni i mësipërm dhe shihet i vlefshëm, midis qiradhënësit dhe pronarit lidhet një marrëveshje, ku përcaktohet vlera e qirasë së trullit që përfiton subjekti i shpronësuar, sipas përcaktimeve në pikën 2 të kapitullit VIII të vendimit të cituar dhe praktika e

tërheqjes së saj. Institucioni ku qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi kryen derdhjen e detyrimit të kontratës, pasi kalon në llogari të pronarit të truallit vlerën sipas marrëveshjes, bën shpërndarjen e të ardhurave sipas kapitullit VI-të të vendimit të cituar.

11. Në zbatim të pikës 2-b të kapitullit të VIII-të, për kontratat e lidhura me sipërfaqe mbi 500 m<sup>2</sup>, me kërkesë të subjektit qiramarrës ose enfiteozëmarrës, kontrata titullari i institucionit që ka lidhur kontratën urdhëron ngritjen e grupit të ekspertëve të përbërë nga një ekspert vlerësimi pasurie dhe një ekspert kontabël, të cilët bëjnë vlerësimin e investimeve të kryera nga qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi për periudhën nga lidhja e kontratës deri në bilancin e vitit të fundit ushtrimor të miratuar dhe hartojnë raportin përfundimtar, i cili i dërgohet për miratim Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike bën krahasimin ndërmjet vlerës së investimit dhe vlerës së truallit, sipas çmimit të truallit të konfirmuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Kur vlerat e krahasuara vërtetojnë që investimet e kryera janë mbi 150 për qind të vlerës së truallit, DAPP përcjell në Drejtorinë e Privatizimit dosjen e cila përmban: kontratën e qirasë ose enfiteozës, kërkesën e subjektit për blerje të drejtpërdrejtë, raportin e miratuar të grupit të ekspertëve për vlerësimin e investimeve, konfirmimin e Agjencisë së Kthimit të Pronave për çmimin e truallit.

Drejtoria e Privatizimit ndjek procedurat e privatizimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.704, datë 11.10.2006 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedurën e shitjes”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË  
DHE ENERGJETIKËS  
**Genc Ruli**

**UDHËZIM**  
**Nr.18, datë 21.8.2007**

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.448, DATË 13.7.2007  
“PËR RRIJTJEN E PENSIONEVE” DHE TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
NR.501, DATË 16.8.2007 “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.448, DATË 13.7.2007  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RRIJTJEN E PENSIONEVE”**

Në mbështetje të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.448, datë 13.7.2007 “Për rritjen e pensioneve” dhe të pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.501, datë 16.8.2007 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.448, datë 13.7.2007 “Për rritjen e pensioneve”, për një zbatim të unifikuar të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.501 me vendimet nr.448, datë 13.7.2007 “Për rritjen e pensioneve”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve” dhe nr.17, datë 20.1.2007 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”, me propozim të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Ministri i Financave,

**UDHËZON:**

1. Mbështetur në pikën 1, geramat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.448, datë 13.7.2007 “Për rritjen e pensioneve”, rritja në masën 5 për qind, për pensionet e qytetit, do të zbatohet mbi masën e pensionit.

2. Mbështetur në pikën 1/1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.501, që ndryshon pikën 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.448, për pensionistët që përfitojnë pensione qyteti pleqërie, invaliditeti dhe familjar, edhe mbas rritjes nuk preken të gjitha kompensimet e të ardhurave mujore të përfituara nga vendimet e veçanta të Këshillit të Ministrave.

3. Mbështetur në pikën 2 geramat “a” dhe “b” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.448, datë 13.7.2007 “Për rritjen e pensioneve”, rritja në masën 10 për qind, për pensionet e fshatit do të zbatohet mbi masën e pensionit.

4. Mbështetur në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.448, për të gjithë pensionistët e fshatit që përfitojnë pensione pleqërie, invaliditeti dhe familjare nuk preken kompensimet e të ardhurave mujore të përfituara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.17, datë 20.1.2007 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve të fshatit”.

5. Mbështetur në pikën 1.2 germat “a” dhe “b” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.501, që ndryshojnë pikën 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.448, nga data 17.8.2007, data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, pensionet e reja të qytetit do të kompensohen sipas kriterëve të përcaktuara në vendimet nr.401, datë 21.6.2006 dhe nr.763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve” kur të ardhurat mujore të tyre rezultojnë në shumën deri në 10 410 lekë.

Pensionet e reja të fshatit do të kompensohen sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.17, datë 20.1.2007 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve të fshatit”, kur të ardhurat mujore të tyre rezultojnë në shumën deri në 5410 lekë.

Të ardhurat mujore të pensionistëve të qytetit që do të përfitojnë pensione të pjesshme, pleqërie, invaliditeti dhe familjare, do të kompensohen në proporcion mes pensionit individual të llogaritur dhe pensionit të plotë minimal, por jo më shumë se 760 lekë në muaj dhe në çdo rast kur shuma e të ardhurave të tyre mujore është në kufirin deri në 10 410 lekë.

Të ardhurat mujore të pensionistëve të fshatit, që do të përfitojnë pensione të pjesshme, pleqërie, invaliditeti dhe familjare, do të kompensohen në proporcion mes pensionit individual të llogaritur dhe pensionit të plotë minimal, por jo më shumë se 690 lekë në muaj dhe në çdo rast kur shuma e të ardhurave të tyre mujore është në kufirin deri në 5410 lekë.

6. Në zbatim të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 27.11.2006, në shumën e të ardhurave mujore të pensionistit do të vazhdojnë të përfshihen, masa mujore e pensionit me datë 1.7.2007, kompensimi i energjisë elektrike, në masën 350 lekë që rrjedh nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.138, datë 31.3.1994 dhe kompensimi i bukës në masën 150 lekë që rrjedh nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.471, datë 15.7.1996.

Ndërsa në kuptim të paragrafit të dytë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 27.11.2006, në shumën e të ardhurave mujore përveç kompensimeve si më sipër do të vazhdojë të përfshihet dhe kompensimi i përfituar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.401, datë 21.6.2006.

7. Në të ardhurat mujore të pensionistëve si për pensionet e pleqërisë edhe për pensionet e invaliditetit dhe ato familjare nuk përfshihen:

a) kompensimi shtesë mbi masën 350 lekë në muaj, i përcaktuar në pikën 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 31.3.1994, që merret nga pensionistë të veçantë për arsye se janë të vetëm, me fëmijë në ngarkim apo kryefamiljarë pa të ardhura të tjera;

b) kompensimi për personat në ngarkim të pensionistit që rrjedh nga zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992 dhe nr.274, datë 12.6.1993;

c) kompensimi shtesë në masën 500 lekë në muaj që rrjedh nga zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.565, datë 9.8.2006, për rimbursimin e energjisë elektrike, i ndryshuar.

d) shtesat mbi pension të parashikuara në nenet 33, 38 dhe 39 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, i ndryshuar, si dhe shtesat e tjera që përfitohen nga ligje apo vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të marrin masa për çeljen, financimin dhe përdorimin e fondeve sipas akteve nënligjore në fuqi.

9. Në mbështetje të pikës 13 të vendimit dhe në zbatim të këtij udhëzimi ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore të përcaktojë procedurat e punës që do të zbatojnë Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për rritjen e pensioneve.

10. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE  
**Ridvan Bode**

**NJOFTIM**  
**Nr.5063, datë 24.8.2007**

**PËR VENDE VAKANTE PËR NOTER NË BASHKINË, TIRANË**

Në zbatim të kërkesave të nenit 3 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, Ministri i Drejtësisë shpall publikisht vendet vakante për noter, si më poshtë:

|         |                                  |
|---------|----------------------------------|
| Bashkia | Numri i vendeve vakant           |
| Tiranë  | 3 (tre) 2 konkurrim+1 transferim |

Ky njoftim botohet në Fletoren Zyrtare, më të parë të radhës.

MINISTRI I DREJTËSISË  
**Ilir Rusmali**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)**  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## **BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

## **BOTIME TË REJA** *(Të përditësuara gusht 2007)*

**KODI PENAL**

**KODI I PROCEDURËS PENALE**

### ***Së shpejti në treg:***

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 24.8.2007  
Doli nga shtypi më 24.8.2007

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 3500 copë | Formati: 61x86/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja “Nënë Tereza”  
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë